

Të dashur prindër,

Qeveria e finlandeze dje më 16.3.2020 ka dhënë një masë urdhëresash, të cilat kanë për qëllim të pengojnë përhapjen e koronavirusit. Në qytetin Vantaa do të veprohet sipas këtyre urdhëresave e për këtë arsye edhe në edukimin e hershëm për fëmijë do të ketë ndryshime.

Kopshtet për kujdesje ditore ndaj fëmijëve, grupet familjare në kopshte dhe përkujdesja ditore për familje si dhe mësimi parashkollor organizohen mundësishtë sipas orarit të zakonshëm.

Megjithatë, nëse ke mundësi me u përkujdes për fëmijën tuaj në shtëpi, mos e bjerë atë në kopshtin për kujdesje ditore. Mos kërkoni nga persona të moshuar ndihmë për ju në përkujdesje ndaj fëmijëve tuaj. Më këtë synojmë pengimin e përhapjes së koronavirusit dhe duam të sigurohemi, se edukimin e hershëm e organizojmë për fëmijët, prindërit e të cilëve janë të obliguar të jenë në vende të punës. Vende të tilla të punës mund të jenë si bie fjala puna në shërbimin social dhe shëndetsor dhe shërbimi për shpëtimin e jetës.

Lajmroje mungesën e fëmijës suaj normalishtë me telefon, me postë elektronike ose me mesazhë telefonik në objektin për edukimin e hershëm duke filluar nga 18.3.2020.

Kopshtet ditore që janë me dyer të hapura, parqet për pjesëmarrje familjare, veprimtaritë e klubeve dhe shërbimi ndihmës i përkujdesjes janë të mbyllura nga 18.3.-13.4.

Ju dërgojmë informata shtesë nëse situata ndryshon. Informata shtesë poashtu mund të merrni nga drejtuesit e kopshteve ditore dhe nga udhëheqësit rajonal të edukimit të hershëm.

Këto udhëzime mbasin në fuqi deri më 13.4.2020.

Përshëndetje miqësore,

Sole Askola-Vehviläinen  
Drejtuese e edukimit të hershëm